



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

### NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti:** Rasti i bashkimit me përthithje të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria Trimed SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar transaksioni i kryer, lidhur me bashkimin me përthithje të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria Trimed SHPK.

Palët pjesëmarrëse:

*Blerësi:* Trimed SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt veprimtarie; Import-Eksport tranzit, Depo Farmaceutike, Përfaqësim në fushat farmaceutike, prodhim-përpunim-konfeksion; import-eksport-tranzitim-tregtim me shumicë e pakicë të medikamenteve, materialeve mjekësore e aksesoreve të tyre, barnave, materialeve dentare e veterinare, higjienosanitare, barnave mjekësore popullore, artikujve të ndryshëm kozmetike e produkteve të parukerisë & estetikës, solucioneve injektabel të lëngjeve të distiluara dhe të gazuara, avulli & akulli, produkteve me origjinë bimore e shtazore, etj. Pajisje laboratorike, marketing dhe promocion. Import-eksport-tranzitim-tregtim me shumicë dhe pakicë të paisjeve mjekësore, pajisjeve dhe instrumenteve ortopedike, protezave të artikulacioneve dhe impianteve dentare.

*Shitësi:* Z. Edmond Hido, është person fizik dhe aksioner i vetëm i shoqërisë Riofarma SHPK, i cili zotëron 100% të aksioneve.

*Shoqëria Target:* Riofarma SHPK, është një shoqëri e themeluar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt të veprimtarisë; Tregtim me shumicë dhe prodhim i medikamenteve farmaceutike, imp-eks i tyre, pajisje, instrumente medicinale, sanitare, ushqime dietale për fëmijë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**